



SHQIPËRI QËNDRIMET QYTETARE PËR ÇËSHTJET EKONOMIKE DHE POLITIKE

Sondazh i Opinionit Publik, prill 2005

9 maj 2005

Qartësim: Sondazhi është bazuar në një vrojtim shkencor me zgjedhje kampionesh. Gjetjet e tij janë përfaqësimi statistikor i opinionëve të publikut shqiptar. Pikëpamjet e raportuara si më poshtë nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

HYRJE

Në Amerikën Veriore dhe Evropën Perëndimore, partitë politike, agjencitë e lajmeve dhe organizatat e shoqërisë civile kryejnë sondazhe të opinionit publik për të testuar qëndrimet e publikut në lidhje me çështjet e aktualitetit të ditës. Partitë politike dhe grupe të shoqërisë civile i përdorin këto rezultate për të zhvilluar plane për të komunikuar me qytetarët. Në këtë kontekst, sondazhet e opinionit publik nuk përdoren si një mjet për të parashikuar rezultatin e zgjedhjeve. **Në këtë kuadër, ky sondazh reflekton “një fotografi” të pikpamjeve të qytetarëve në mesin e muajit prill. Ai nuk duhet të shihet si një parashikim i rezultatit të zgjedhjeve parlamentare të korrikut 2005.**

Raporti i mëposhtëm është një paraqitje dhe analizë e gjetjeve kryesore të një sondazhi të opinionit publik në Shqipëri të kryer në muajin prill. Ky sondazh është pronë e National Democratic Institute for International Affairs (NDI). Punën në terren e kreu Prism Research (Studimet/Kërkimet Prizëm), një kompani sondazhesh e themeluar në Australi në vitin 1996, me zyra në Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Serbi dhe Mal i Zi, Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri. Klientela e Prism Research përfshin një numër të madh organizatash shumëkombëshe, ndërkombëtare dhe vendase, përfshirë NDI.

Qëllimi i NDI/Shqipëri në kryerjen e këtij sondazhi është që të ndihmojë partitë politike në Shqipëri në përmirësimin e kapaciteteve të tyre për të kuptuar dhe për t'iu përgjigjur interesave të qytetarëve. Ky sondazh është pjesë e një programi për zgjedhje të pastra/antikorrupsion të kryer nga Konsorciumi për Demokraci dhe Qeverisje në Shqipëri (DGA) i cili përfshin NDI, IREX, dhe Partners for Democratic Change. Programi DGA financohet nga Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Ndërmjet 19 dhe 27 prillit, 1,251 të intervistuar të moshës mbi 18 vjeç në Shqipëri, morën pjesë në intervista ballë për ballë të cilat ishin hartuar për të matur qëndrimin e tyre në lidhje me shqetësimet për politikën e ditës që përfshijnë mendimin e tyre mbi ekonominë, rritjen e vendeve të punës, sfidat e infrastrukturës, korrupsionin dhe gjendjen politike. Kampionet e intervistave u përzgjedhën në mënyrë rastësore dhe ishin të shpërndara njëtrajtësisht sipas ndarjes gjeografike. Kjo u bazua në të dhënat e regjistrimit më të fundit të votuesve në secilin prej 12 qarqeve të Shqipërisë.

Kufiri i gabimit në një kampion prej 1,251 është +/- 3 përqind.

PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Shqetësimi më i rëndësishëm: Ekonomia, Infrastruktura dhe Varfëria.

Çështja kryesore në mendjet e votuesve është ekonomia. Kur përgjigjësit u pyetën për të shquar çështjen më të rëndësishme me të cilën ndesheshin, 54 përqind e tyre identifikuan ekonominë, 39 përqind infrastrukturën dhe 38 përqind varfërinë. Tek ekonomia, çështjet më shqetësuese për qytetarët janë: mungesa e vendeve të punës (60 përqind), rrogat e ulëta (41 përqind) dhe taksat e larta (32 përqind). Për mungesën e vendeve të punës të intervistuarit fajësonin korrupsionin (65 përqind), burokracinë qeveritare (38 përqind), dhe taksat e larta (28 përqind). Në lidhje me infrastrukturën, përgjigjësit identifikuan energjinë elektrike, ujin dhe rrugët si përparësitë më të rëndësishme. Në këndvështrimin demografik, ekonomia është më e rëndësishme për të intervistuarit në Jug (60 përqind) krahasuar me ata në Veri (47 përqind). Po ashtu dhe me të intervistuarit në zonat urbane (61 përqind) krahasuar me ata në zonat rurale (46 përqind). Jo rastësisht, ata që bëjnë pjesë në grupet e ulëta social-ekonomik dhe të papunët e rendisin ekonominë si më të rëndësishme krahasuar me ata që janë në marrëdhënie pune dhe ata që gëzojnë kushte ekonomike më të rehatshme.

Korrupsioni

Kur iu kërkua që të identifikonin përgjegjësinë për nivelet aktuale të korrupsionit, të intervistuarit u përgjigjën se udhëheqësit gjyqësorë dhe politikë janë përgjegjës përkatësisht në 75 dhe 73 përqind. Studentët (84 përqind), ata që kërkonin punë (85 përqind) dhe ata që banonin në Veri (82 përqind) gjykonin më ashpërsisht gjyqësorin, ndërsa pensionistët dhe ata mbi moshën 51 vjeç (përkatësisht 67 dhe 69 përqind) janë më pak të ashpër. Të intervistuarit në zonat urbane (77 përqind) dhe katër të pestat e atyre që ishin të papunë janë më të prirur për të konsideruar udhëheqësit politikë si tejet përgjegjës për korrupsionin në krahasim me vetëm dy të tretat e pensionistëve, shtëpiakeve dhe të atyre në zonat rurale. Shumë prej po këtyre të intervistuarve identifikuan interesat financiare vetjake (63 përqind) dhe etjen për pushtet (59 përqind) si çështjet të cilat motivojnë politikanët, ndërsa vetëm 16 përqind e tyre beson se vendimet e politikanëve motivohen prej interesit të komunitetit. Kur të intervistuarit u pyetën se cilat ishin metodat që ata mendonin se ishin të suksesshme për të luftuar korrupsionin ata më së shumti mbështetën këto metoda: dënimin e shkelësve të ligjit, vëzhgimin efektiv dhe legjislacioni i ri. Por, më pak se gjysma e të gjithë të intervistuarve (45 përqind) mendojnë se shikimi i buxheteve të qeverisë nga ana e qytetarëve për të vëzhguar shpenzimet e saj është një mënyrë efektive për të ulur korrupsionin.

Zgjedhje të Lira dhe të Drejta

Kur u pyetën për rreziqet e mundshme në lidhje me ndershmërinë e zgjedhjeve të ardhshme parlamentare, të intervistuarit thanë se shqetësimi në lidhje me pasaktësinë e listave të votuesve është çështja më e rëndësishme (66 përqind), pasuar nga shqetësimi për

parregulltësitë e mundshme të numërimit të votave (60 përqind) si dhe kufijtë e zonave dhe ndërhyrja e policisë (41 përqind secila). Më shumë se gjysma e të intervistuarve (54 përqind) mendojnë se qeveria i ndëshkoi ato komunitete që votuan kundër saj. Kur u pyetën se kë besonin për të vëzhguar zgjedhjet, bashkësia ndërkombëtare merrte besimin e 57 përqind të të intervistuarve, e ndjekur nga afër prej Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me 47 përqind dhe vëzhguesit vendas të zgjedhjeve me 44 përqind. Vetëm një në gjashtë (16 përqind) mendon se partitë politike mund të besohen për të vëzhguar zgjedhjet.

Synimi i Votuesve

Të pyetur se për kë do të votonin nëse zgjedhjet do të mbaheshin këtë javë në Shqipëri, afërsisht një e treta e të intervistuarve (32 përqind) ishin të pavendosur ose nuk dhanë përgjigje. Mes votuesve të vendosur, 42 përqind thanë se do të votonin për Partinë Demokratike (PD), 34 përqind për Partinë Socialiste (PS), 11 përqind për Partinë Socialiste për Integrim (LSI) dhe 4 përqind për Lëvizjen për Zhvillim Kombëtar (LZHK). Kur u pyetën që të shprehnin opinionet e tyre për udhëheqësit politikë, asnjëri prej të dy personave që rezultuan në krye të listës nuk është udhëheqës i ndonjë partie politike, Edi Rama me 67 përqind dhe Prof. Dr. Rexhep Meidani me 54 përqind.


Ndarjet Demografike

Faktori kryesor demografik që ndan opinionin në Shqipëri duket së është ai gjeografik. Në veçanti, ata që jetojnë në rrethet jugorë të Vlorës, Gjirokastrës, Korçës, Fierit dhe Beratit janë dukshëm më të larguar nga qeveria dhe më të interesuar të shohin punët e tyre. Banorët në rrethet veriorë të Shkodrës, Dibrës, Lezhës dhe Kukësit, gjithashtu, shprehin këtë shpirt pavarësie - megjithëse jo aq shpesh. Të intervistuarit nga rrethet e Shqipërisë së Mesme, si në Elbasan, Tiranë dhe Durrës kanë një kuptim më të mirë për rolin e qeverisë si dhe kanë më shumë besim te institucionet e saj. Veriorët shfaqen më të varur te ndihma e dhënë nga bashkësia ndërkombëtare dhe qeveria, duke shprehur, relativisht më shumë shqetësim rreth atyre çështjeve në të cilat ndërhyjnë si qeveria ashtu dhe agjencitë e ndihmës ndërkombëtare, p.sh., rrugët, transporti publik dhe mbështetja e fermerëve.

Një tjetër ndarje e dukshme demografike ekziston ndërmjet banorëve të zonave urbane dhe rurale. Ata që jetojnë në zonat urbane janë më pesimistë për ekonominë (56 përqind) përballë 50 përqind në zonat rural, gjë që shpjegon se pse ekonomia është më e rëndësishme për banorët urban, 48 përqind krahasuar me 35 përqind për banorët e rural. Në të njëjtën kohë, banorët urban janë më të hapur ndaj tregëtisë së lire (61 përqind përballë 47 përqind të banorëve rural) dhe tre herë më të shqetësuar për cilësinë e ajrit se sa ata në zonat rurale.

Gjithashtu vërehen ndryshime të tjera rastësore demografike mes studentëve, pensionistëve dhe shtëpiakëve. Dy grupimet e fundit demonstrojnë izolim nga shoqëria dhe proceset e saj të reformimit, ndërsa pjestarët e grupit para tyre janë të vetëdijshëm për përparësitë e modernizimit në Shqipëri dhe për përvojat e pjesës tjetër të Evropës.

ÇËSH TJET MË TË RËNDËSISHME



Më shumë se gjysma e të intervistuarve zgjedhën ekonominë si çështjen e parë ose të dytë më të rëndësishme me të cilën ndeshen së fundi, pasuar nga infrastruktura dhe varfëria.


Mesatarisht, 23 përqind e të intervistuarve besojnë se PD-ja është partia që do t'i adresonte më së miri çështjet e mësipërme, ndërsa 20 përqind identifikojnë PS-në. Por, 36 përqind e të intervistuarve nuk mund të identifikojnë një parti e cila do të ishte më e mira për të adresuar çështjet ose besojnë se asnjë parti nuk mund të adresojë/ t'i drejtohet çështjeve shqetësuese.

SHQETËSIMET SPECIFIKE EKONOMIKE

Të intervistuarit e papunë janë shumë më të shqetësuar për mungesën e vendeve të punës, por edhe ata që janë të punësuar shqetësohen më shumë për natyrën e përkohëshme të kësaj pune. Këto përgjigje demonstrojnë pasiguri për të ardhmen.

Taksat e larta përbëjnë shqetësim për të intervistuarit në Jug, ndërsa Veriu dhe zonat rurale i mëshojnë më shumë mbështetjes bujqësore dhe infrastrukturore. Ata që banojnë si në rrethet veriore ashtu dhe qendrore janë të shqetësuar për përmirësimet infrastrukturore.


Shqetësimi Ekonomik më i Rëndësishëm



ARSYET PER RRRITJEN E NGADALTË TË VENDEVE TË PUNËS

Pothuajse dy të tretat e të intervistuarve (65 përqind) identifikuan korrupsionin si shkakun e parë ose të dytë më përgjegjës për rritjen e ngadaltë të vendeve të punës, pasuar nga burokracia e qeverisë me 38 përqind.


19 përqind e studentëve identifikuan “mungesën e aftësive të duhura” si faktorin përgjegjës për rritjen e ngadaltë të vendeve të punës, ndërsa pensionistët (32 përqind) dhe ata që jetojnë në rrethet e jugut (28 përqind) janë më të prirur të fajësojnë burokracinë qeveritare. Megjithatë, si përgjigje e parë, korrupsioni konsiderohet si më përgjegjësi nga ata që jetojnë në Veri (41 përqind) dhe ata që jetojnë në Jug (35 përqind).



SHQETESIMET SPECIFIKE INFRASTRUKTURE

Të intervistuarit identifikuan energjinë elektrike, ujin dhe rrugët si çështjet infrastrukturore më të rëndësishme.

Zgjedhja ndryshon sipas krahinave, ata që jetojnë në Jug dhe Veri janë më të shqetësuar për energjinë elektrike (respektivisht, 59 dhe 55 përqind). Ata që jetojnë në Shqipërinë e Mesme janë më të shqetësuar për rrugët në një nivel prej 50 përqind. Për ata që jetojnë në Jug shqetësimi i dytë më i rëndësishëm është uji me 56 përqind, ndërsa për ata që jetojnë në Veri shqetësimi i dytë për nga rëndësia janë rrugët me 53 përqind. Gjithashtu, ata që jetojnë në zonat rurale janë më të prirur të zgjedhin transportin publik si një shqetësim të rëndësishëm infrastrukturor.



QENDRIMET PËR REFORMAT E POLITIKAVE

Sondazhi u përpoq të vërtetonte opinionet e shqiptarëve për zhvillimet e ardhshme politike dhe ekonomike. Si fillim, 57 përqind e të intervistuarve besojnë se gjendja politike po shkon në një drejtim të gabuar, ndërsa 53 përqind mendojnë se gjendja ekonomike po shkon në një drejtim të gabuar. Kur u pyetën se cila thënie përfaqësonte më së miri opinionin e tyre për disa çështje reformash ekonomike, të intervistuarit u përgjigjën si më poshtë:

| TAKSIMI | |
|---|-----|
| Ulja e taksave do të jetë një gjë e mirë për shkak se atëherë njerëzit do të jenë të aftë të vendosin vetë se si të shpenzojnë paratë në mënyrën më efektive. | 51% |
| Ulja e taksave nuk është ide e mirë për shkak se do të thotë më pak para për infrastrukturën, kujdesin shëndetësor dhe shkollat. | 40% |
| Nuk e di/S'mund të vendos/Pa përgjigje | 10% |

| TREGËTIA E LIRE | |
|---|-----|
| Tregëtia e lirë është e mirë për pranimin e Shqipërisë në BE, dhe nuk duhet kufizuar. | 54% |
| Tregëtia e lirë dëmton fermerin shqiptar, dhe duhet kufizuar. | 37% |
| Nuk e di/S'mund të vendos/Pa përgjigje | 9% |


| KRIJIMI I VENDEVE TE PUNES | |
|---|-----|
| Qeveria duhet të krijojë vende pune për njerëzit. | 71% |
| Njerëzit duhet të marrin nismën dhe të fillojnë biznes në mënyrë që të krijojnë vende pune. | 25% |
| Nuk e di/S'mund të vendos/Pa përgjigje | 4% |

Të intervistuarit duket se besojnë se një rol madhor i qeverisë është krijimi i vendeve të punës. Në të njëjtën kohë, shumica demonstroi shpirt sipërmarrjeje ose beson se ata mund të shpenzojnë paratë më me urtësi se sa qeveria. Për më tepër, një shumicë e të intervistuarve kupton se qëllimi aktual është integrimi Evropian dhe dëshirojnë të ndërmarrin reformat e nevojshme për këtë proces.

KORRUPSIONI


Deri në ç' shkallë janë të korruptuar njerëzit në profesionet te mëposhtme?

Të inervistuarit që jetojnë në rrethet e jugut janë më të prirur të gjykojnë ashpër drejtuesit e bizneseve dhe administratës publike, ndërsa janë më pak të prirur të dyshojnë mjekët për korrupsion. Gjithashtu, banorët e zonave rurale janë më pak të prirur vlerësojnë policinë si të korruptuar në krahasim me ata që jetojnë në zonat urbane.



Motivimi i Politikanëve

Gjithashtu, sondazhi përmbante pyetjen se në ç'shmallë ishin përgjegjës për nivelin aktual të korrupsionit gjykatësit, udhëheqësit politikë, punonjësit e qeverisë, policia dhe biznesmenët. Të intervistuarit i vlerësojnë të gjithë grupet si të paktën 50 përqind përgjegjës dhe deri në 75 përqind përgjegjës për korrupsionin me përjashtim të biznesmenëve të cilët konsiderohen se janë vetëm 46 përqind për korrupsionin. Ashtu si dhe në diagramin në faqen e mësipërme, gjykatësit dhe udhëheqësit politikë janë 73 përqind përgjegjës dhe konsiderohen si më përgjegjës.



Duke pasur parasysh përçmimin e përgjithshëm ndaj udhëheqësve politikë, është interesante që dy të tretat e të intervistuarve besojnë se politikanët motivohen prej interesit financiar personal. Pothuajse po aq, besojnë se politikanët motivohen prej etjes për pushtet. Vetëm një në gjashtë beson se politikanët motivohen prej interesit të komunitetit.

Rrugëzgjdhjet ndaj Korrupsionit

Cilat prej masave të mëposhtëme do të ishin të efektshme për uljen e korrupsionit?

| RRUGEZGJIDHJE | Efektive | Jo Efektive | Nuk e di/Pa Përgjigje |
|---|-----------------|--------------------|------------------------------|
| Kontrolli i shpenzimeve qeveritare dhe çuarja në gjyq e rasteve të korrupsionit. | 71% | 21% | 7% |
| Krijimi i njësisë brenda institucioneve të shtetit për të vëzhguar dhe eliminuar korrupsionin. | 64% | 28% | 8% |
| Krijimi i ligjeve që mbrojnë dhe shpërblejnë ata që raportojnë rastet e korrupsionit në vendet e tyre të punës. | 56% | 36% | 9% |
| Nxitja e njerëzve për të mos paguar rryshfete. | 50% | 41% | 9% |
| Të lejohet media dhe OJQ-të që të shikojnë dhe vëzhgojnë buxhetet dhe shpenzimet e qeverisë. | 45% | 45% | 10% |

Në të gjitha rastet, ata që jetojnë në rrethet e jugut gjykojnë secilën prej këtyre masave si më efektive në krahasim me “të gjithë të intervistuarit”, ndërsa ata që jetojnë në pjesën e mesme janë më dyshues ndaj dënimit të njerëzve, vëzhgimit të korrupsionit dhe legjislacionit të ri. Ata që banojnë në rrethet e Veriut janë më dyshues ndaj dënimit të njerëzve.


ZGJEDHJE TË LIRA DHE TË DREJTA

Listat e votuesve ende vazhdojnë të mbeten një shqetësim domethënës për të intervistuarit si në zgjedhjet e mëparëshme, po ashtu si dhe parregullsitë në numërim.

Në të njëjtën kohë, një mesatare prej 10 përqind të të intervistuarve nuk e di se në ç'shikallë këto çështje mund të rrezikojnë zgjedhjet e lira dhe të drejta.

Ata që jetojnë në rrethet e Jugut dhe të Veriut mendojnë me respektivisht 63 përqind dhe 60 përqind, se qeveria është më e prirur të penalizojë interesat e komuniteteve të atyre që votojnë kundër saj, ndërsa vetëm 44 përqind e atyre nga rrethet e Shqipërisë së Mesme e shprehin këtë shqetësim. Përveç kësaj, 58 përqind e votuesve ruralë janë më të prirur t'i druhen ndëshkimit sesa votuesit urbanë me 51 përqind.

Rreziqet Ndaj Zgjedhjeve të Lira dhe të Drejta




Besimi për Vëzhgimin e Zgjedhjeve:

Të intervistuarit që jetojnë rrethet e Veriut janë më të prirur të zgjedhin Bashkësinë Ndërkombëtare si zgjedhjen e tyre të parë, ndërsa ata në rrethet e Jugut janë më të prirur të zgjedhin vëzhguesit vendas si personat që u besojnë më shumë për të vëzhguar procesin zgjedhor. Veç kësaj, si zgjedhje të parë dhe të dytë, studentët janë më të prirur se çdo grup tjetër demografik që të identifikojnë median.

Burimi i Informacionit për Aktualitetin:

Pothuajse dy të intervistuarve identifikojnë televizionin kombëtar si burimin kryesor të informacionit për zhvillimet aktuale, pasuar nga televizionet lokale me 17 përqind, që do të thotë se dy në dhjetë persona informohen prej mediumesh të tjera të ndryshme nga televizioni. Në fakt, më pak se 1(një) përqind mësojnë për zhvillimet aktuale prej udhëheqësve politikë vendor dhe më pak se 4 përqind prej anëtarëve të familjes.


Te Cili Keni më Shumë Besim për Vëzhgimin e Procesit të Zgjedhjeve?




BESIMI TE INSTITUCIONET

Të intervistuarit u pyetën se sa besim kishin te institucionet e mëposhtëme. Televizioni dhe bashkësia ndërkombëtare janë mes më të besuarave, me këtë të fundit që gëzon nivelet më të larta të besimit të plotë. Partitë politike, udhëheqësit e OJF-ve, zyrtarët e qeverisjes lokale, gjyqësori dhe gazetat gëzojnë më pak se 50 përqind besim.

Besimi te Institucionet




QËNDRIMI NDAJ UDHËHEQËSVE POLITIKË KYÇ



SYNIMI I VOTUESVE

“Nëse zgjedhjet e përgjithshme në Shqipëri do të zhvilloheshin këtë javë për cilën parti do të mund të votonit?”


Të gjithë të Intervistuarit



Votuesit urbanë janë më të prirur drejt PD-së, LSI-së dhe LZHK-së, ndërsa PS-ja ruan një kryesim të ngushtë në zonat rurale dhe mes pensionistëve. Ndonëse më e dobët mes pensionistëve PD-ja ka një epërsi mes të papunëve.

Partia Demokratike (PD), Partia Socialiste (PS), Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZHK), Partia Republikane (PR). Të gjitha partitë e tjera morën më pak se 2 përqind të mbështetjes mes të intervistuarve të kampionuar. Të Pavendosur/Pa Përgjigje përfshin ata që u përgjigjen “nuk e di”, “s’ mund të vendos”, “pa përgjigje”, dhe “nuk dua të përgjigjem”.

Vetëm* Votuesit e Vendosur



Partia Demokratike (PD), Partia Socialiste (PS), Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI), Lëvizja për Zhvillim Kombëtar (LZHK), Partia Republikane (PR). Partia Socialdemokrate (PSD) Partia Bashkimi për të Drejtat të Njeriut (PBDNJ).

* **Votuesit e Vendosur:** Në fushën e sondazhit të opinionit publik, thuhet se, në ditën e zgjedhjeve, “të pavendosurit”, dhe “pa përgjigjet”, bëjnë zgjedhje në raporte të barabarta në krahasim me ata që kanë vendosur aktualisht. Prandaj, sondazhierët do të shpërndajnë të intervistuarit e pavendosur dhe ata që nuk janë përgjigjur në përpjestim të drejtë mes partive dhe do të tregojnë vetëm rezultatet e votuesve të vendosur.